



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPSTINA VUCITRN

PROCESVERBAL

nga mbledhja e VIII-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më
15 tetor 2020 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Nasuf Aliu (kryesues), Melihate Basholli-Latifi, Gresa Muli, Ymer Haradinaj, Shkëlzen Feka, Arta Ymeri, Nezir Klinaku dhe Teuta Aruçi Shartari (anëtarë të KPF -së).

Mungoi: Shpëtim Zhegrova.

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: drejtorët e drejtorive (Lutfi Gërguri, Refik Maloku dhe Berat Sadiku), si dhe nga sekretaria e kuvendit: Bastri Duraku dhe Bujar Klinaku.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së, i cili konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

Ai tha se kanë ardhur edhe disa pika për t'i futur në rend të ditës si:

- Draft Rregullore për realizimin e të drejtave, përkujdesjen, mbrojtjen dhe parandalimin e punëve të rënda për fëmijë (shqyrtimi i parë);
- Peticion i banorëve të lagjës "Ramadan Fazliu";
- Kërkesë nga kryetari i lagjës "Kalaja";
- Kërkesë nga Murat Ademi lidhur me rifillimin e mësimi në shkollën e Skromës.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – theksoi se diçka nuk është rregull, se ka ndoshta dhjetë vite që Ismail Haziri dërgon kërkesa për problemin në lagjën "Kalaja". Ndoshta do të ishte mirë që të formohet një komision që të dalë në terren dhe ta shikojë gjendjen.

Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF-së – tha se është e vërtetë që kemi shumë kërkesa nga Ismail Haziri dhe se edhe një takim që kemi pasur "online", prapë ngriti shqetësimet në atë lagje. Prandaj, sa jam në dijeni, sa i përket çështjes me dokumente, komuna i është përgjigjur, kurse me veprime në praktikë nuk jam në dijeni. E di që përpara është thirrur edhe ezani aty.

Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – deklaroi se sipas informatave që posedojmë, parcela për të cilën po bëhet fjalë është pronë private. Inspeksioni ka dalë në terren dhe nuk ka parë ndonjë shkelje. Prandaj, si komunë nuk kemi të drejtë që t'ia ndalojmë dikujt t'i kryej ritet fetare në shtëpi private. Ai tha se kryesuesi e përmendi që përpara është thirrur ezani, por kjo tani nuk ndodhë.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – theksoi se më duket që ka qenë një komision në mandatin e kaluar lidhur me këtë çështje dhe se nuk e dimë a kanë bërë ndonjë raport.

Gresa Muli, anëtare e KPF-së – tha se dje u njoftova se është parashtruar një peticion prej rreth 100 nënshkrimeve nga dy lagje në Vushtrri (afër fabrikës së ngjyrave "Extra color"). Shqetësim i tyre, sipas banorëve është se aty ka qenë një gurëthyes, por tash e kanë marrë lejen

edhe për një betonierë që është afër shtëpive dhe se po e vështirëson jetën e qytetarëve. Banorët më njoftuan se kanë parashtruar peticion në komunë (16 prill 2018), por se komuna nuk është marrë me këtë çështje.

Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – deklaroi se betonierë, gurëthyesit etj. bëjnë pjesë në kategorinë e tretë dhe se këto leje i lëshon Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, kurse pajisja me licencë bëhet nga Komisioni i Pavarur për Minerale dhe Miniera.

Ne u kemi kthyer përgjigje sipas Planit Zhvillimor Komuna që komuna nuk ka ndonjë interes për atë parcelë.

Sipas procedurave, për ndërtimin e një betoniere apo gurëthyesi, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale është dashur të mbajë diskutim publik (ndoshta edhe ka mbajtur), por që ne nuk jemi informuar si drejtori.

Sa i përket gurëthyesit, sipas ligjit parashihet që në 500 metra distancë nuk duhet të ketë shtëpi (banim), kurse për betonierë nuk është e specifikuar.

Gresa Muli, anëtare e KPF-së – theksoi se si kuvend komunal a mund të bëjmë diçka në këtë drejtim, ndonjë reagim për të adresuar në ministri, për t'iu dalë në ndihmë qytetarët.

Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – tha se peticionin mund ta dërgojmë në ministri. Ai sugjeroi që qytetarët le ta dërgojnë edhe një herë këtë peticion në drejtorinë tonë, ne pastaj do t'ua përcjellim në ministri.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – tha se po e paraqes një shqetësim për gjendjen e pastërtisë në sallë të kuvendit ku jemi këtu, ku po shihet se ka pluhur të madh dhe se kemi disa pako të vendosura. Prandaj, nuk është bërë dezinfektimi i sallës, ku sipas rekomandimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovë një gjë e tillë duhet të bëhet shpesh për shkak të pandemisë me Covid 19.

Kërkoj që herëve tjera, organet kompetente ta bëjnë dezinfektimin, ajrosjen, pastrimin, në mënyrë që pastërtia të jetë në nivelin e duhur.

Komiteti për Politikë dhe Financa me katër (4) vota “për” dhe një (1) votë “kundër” aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 14 shtator 2020;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja urgjente e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 22 shtator 2020;
3. Shqyrtimi i Draft – Strategjisë komunale për komunikim 2021 – 2023 (**shqyrtimi i parë**);
4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore për vitin 2019 të KRM “Uniteti” Sh. A. Mitrovicë;
5. Shqyrtimi i Raportit nëntëmujor mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;
6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me mbrojtjen e mjedisit;
7. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e vitit shkollor 2019/2020 dhe përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2020/2021;

8. Shqyrtimi i Informatës lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të tokave bujqësore;
9. Shqyrtimi i Informatës nëntëmujore lidhur me zhvillimin dhe realizimin e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive, duke përfshirë teatrin, bibliotekën dhe muzeun;
10. Shqyrtimi i Draft Rregullores për realizimin e të drejtave, përkujdesjen, mbrojtjen dhe parandalimin e punëve të rënda për fëmijë (shqyrtimi i parë);
11. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 14 shtator 2020.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 14 shtator 2020.

2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja urgjente e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 22 shtator 2020.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 22 shtator 2020.

3. Shqyrtimi i Draft – Strategjisë komunale për komunikim 2021 – 2023 (shqyrtimi i parë).

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore për vitin 2019 të KRM “Uniteti” Sh. A. Mitrovicë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës. Po ashtu, u kërkua që përfaqësuesi i KRM “Uniteti” Sh. A. Mitrovicë të jetë i pranishëm në seancë.

5. Shqyrtimi i Raportit nëntëmujor mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me mbrojtjen e mjedisit.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

7. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e vitit shkollor 2019/2020 dhe përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2020/2021.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

8. Shqyrtimi i Informatës lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të tokave bujqësore.

Gresa Muli, anëtare e KPF-së – tha se është e shqetësuar për mënyrën se si po bëhen ndërtime në pronën që e kemi dhënë në shfrytëzim tek “Ura e Gurit”. Kanë filluar të bëhen ndërtime me beton në atë vend dhe se kjo është shqetësuese. Prandaj, lidhur me këtë a ka ndërmarrë komuna diçka në këtë drejtim dhe se a është në dijeni.

Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – theksoi se në vitin 2016, investitori e ka dorëzuar një projekt (në bazë të informatave që i kemi marrë nga drejtoria) për rregullim të restaurantit, për shkak të disa telasheve në pjesën e kulmit. Ai projekt i është drejtuar Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve, ku është kthyer në formë të vendimit, ku i është lejuar rregullimi i asaj hapësire. Drejtoria për Inspektime ka nxjerrë një vendim për ndërprerje të punimeve dhe punimet i janë ndërprerë para dy dite.

Sot kemi pasur takim me inspektoratin e Institutit për Trashëgimi Kulturor dhe përfaqësues nga Ministria e Kulturës, me ç’rast kemi kërkuar që të vazhdohet me pezullimin e punimeve. Në vendimin e Institutit ceket se u lejohen punimet për konstruksion montazhë dhe për këtë arsye janë ndërprerë punimet pasi që nuk është respektuar ky vendim. Prandaj, jemi në pritje të një përgjigje nga niveli qendror.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – kërkoj nga drejtoria që kjo informatë të përmirësohet për kuvend, pasi që titulli me përmbajtjen nuk është në harmoni.

9. Shqyrtimi i Informatës nëntëmujore lidhur me zhvillimin dhe realizimin e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive, duke përfshirë teatrin, bibliotekën dhe muzeun.

Melihate Basholli Latifi, anëtare e KPF-së – kërkoj që për kuvend të përmirësohet kjo informatë, pasi që teatri, biblioteka dhe muzeu janë pjesë e drejtorisë dhe se nuk janë të ndara.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – kërkoj që deri në mbledhjen e kuvendit të komunës, që është planifikuar të mbahet më 29 tetor 2020, të na sjell dokumentin për mënyrën e shfrytëzimit të stadiumit “Ferki Aliu” në Vushtrri. Pra, nga kush shfrytëzohet stadiumi, cilat klube e shfrytëzojnë? Nëse nuk ekziston ky dokument për mënyrën e shfrytëzimit, a ka objektivë Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport që në të ardhmen ta menaxhojë stadiumin “Ferki Aliu” në Vushtrri.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

10. Shqyrtimi i Draft Rregullores për realizimin e të drejtave, përkujdesjen, mbrojtjen dhe parandalimin e punëve të rënda për fëmijë (shqyrtimi i parë).

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se është bërë si traditë e keqe që dokumentet që janë në shqyrtim të parë nuk e lexojmë fare, sepse thuhet që në shqyrtim të dytë do ta lexojmë.

Mbledhja përfundoi në orën **15:15**.

Bujar Klinaku

Bujar Klinaku
Procesmbajtës

Nasuf Aliu

Nasuf Aliu
Kryesues i KK-së dhe i KPF-së